



SBASHK

Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kultures

Arsimimi

KULTURA E NJERIUT



Ë-buletin

Maj, 2018

Vazhdon rrugëtimi I mbarë i Ligjit për vitet e 90-ta

Deputetet në mbështetje të këtij ligji në leximin e parë



SBASHK-u i kishte dhënë prioritet angazhimeve në shërbim të realizimit të kërkesës madhore për të dërguar Projektligjin për statusin e punëtorëve të arsimit shqip të Republikës së Kosovës për vitet e 90-ta. Janë bërë shumë angazhime dhe përmes dialogut social dhe përmes veprimeve sindikale nga ana e SBASHK-ut duke dëshmuar kështu përkushtimin për të kryer misionin që kishim marrë në shenjë respekti për të punësuarit e asaj kohe të ... (faqe 5)

Pjesëmarrje në takime të nivelit të lartë sindikal

Në Bruksel takim i rëndësishëm për sindikatat dhe arsimin



Se kjo Konferencë ishte e rëndësishë së veçantë flet edhe fakti se në të mori pjesë edhe ... (faqe 7)

Vazhdon forcimi i kapaciteteve për udhëheqje efektive të dialogut social

Pjesëmarrësit e vlerësojnë lartë këtë aktivitet sindikal të SBASHK-ut
SBASHK-u është duke vazhduar me ... (faqe 5)

Intervistë me nënkryetaren e SBASHK-ut, Vjollca Shala

Vjollca : Janë shënuar shumë arritje në SBASHK

Vjollca Shala është zgjedhur nga Këshilli Drejtues , më 17 mars 2018, nënkryetare e SBASHK-ut. Ajo ka punuar fillimisht me përkushtim në cilësinë... (faqe 3)

Në Sofje Sindikatat nga e tërë Evropa diskutojnë për Ballkanin Perëndimor

Kontribut për takimin e 17 majit të krerëve të shteteve



Në Sofje të Bullgarisë, që është kryesuese e Këshillit të Evropës, është organizuar Konferencë e nivelit të lartë në kohezionin ekonomik e shoqëror për Ballkanin Perëndimor... (faqe 8)



Editorial

Të përgatitemi për sfidat e kohës



Jemi sektor shumë i rëndësishëm dhe nëpër vite e dekada jemi përballur me sfida, por çdo herë falë përkushtimit dhe vetëdijes së lartë se po kryejmë misionin tonë në shërbim të atdheut ia kemi dalë.

Në vitet e e 90-ta u bëmë shembull unik dhe i vetëm në botë në mbrojtje të arsimit e kulturës sonë karshi furtunave e sulmeve të vazhdueshme të pushtuesit. U kthyem në digë mbrojtëse dhe dolëm ballëhapur.

Tani është një kohë tjetër, por sfidat nuk janë të pakta. Bashkërisht dhe me veprime të duhura realizuam shumë nga kërkesat. Edhe Projektligji për vitet 90-ta pas shumë angazhimeve e përkushtimit u votua në

Qeveri dhe u dërgua në Parlament për ta pasur edhe leximin e parë dhe për ta gëzuar përkrahjen e madhe të deputetëve shqiptar.

Kjo kohë do të sjellë sfida të reja dhe ne mësimdhënësit duhet të jemi të përgatitur. Duhet më shumë kohë të kalojmë duke fituar njohuri për teknologjinë informative dhe për punën me kompjuter sepse kështu do të ecim me kohën dhe do ta kemi më lehtë të përballemi me kërkesat e mëdha të kohës. Janë duke ndodhur zhvillime të shumta e ecje marramendëse në teknologji dhe prandaj ne duhet të jemi aty dhe të fitojmë njohuri të reja për t'i vënë ato në shërbim të punës dhe arritjeve edhe më të mëdha.

Për çdo pyetje, sugjerim apo informata shtesë , mund të vizitoni ueb-faqen tonë:

www.sbashk-rks.org

Mos hezitoni të na jepni sygjerrime për përfshirjen edhe të ndonji rubrike në interes të anëtarësisë në gazeten e juaj elektronike Arsimi sot.

Që SBASHK-u të jetë gjithnjë në shërbim të anëtarësisë, së shpejti do të ofroj shërbime këshillimi për ngritje profesionale për anëtarët e vet si dhe së shpejti do të paraqiten video-spote në ueb-faqen e SBASHK-ut rreth shërbimeve për anëtarësinë.

Botues: Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës e Kosovës (SBASHK)
përfaqëson rreth 20.500 anëtarë në gjithë sektorët e arsimit në Kosovë, duke përfshirë edhe komunitetet. SBASHK është anëtare e **Edukimit Internacional (EI)** që nga viti 1996.

Email: info@sbashk-rks.org

Tel. +381(0)38/ 226 940



Intervista

Intervistë me nënkryetaren e SBASHK-ut, Vjollca Shala

Vjollca : Janë shënuar shumë arritje në SBASHK



Vjollca Shala është zgjedhur nga Këshilli Drejtues , më 17 mars 2018, nënkryetare e SBASHK-ut. Ajo ka punuar fillimisht me përkushtim në cilësinë e kryetares së Kuvendit të SAF e SAM te Mitrovicës, Me punë e

përkushtim ka bërë që të shtohen angazhimet e femrave në aktivitetet e SBASHK-ut dhe gjithnjë e më shumë kolege janë duke marrë përgjegjësitë për të udhëhequr me shoqatat sindikale kudo në shkollat e Kosovës. “Janë shënuar shumë arritje në SBASHK, por ka mbetur ende punë për t’u bërë”, shprehet Vjollca në këtë intervistë për gazetën tonë.

Arsimi sot:

Kush është Vjollca Shala?

Vjollca:

Kam lindur në Mitrovicë. Shkollën fillore dhe të mesme e kam mbaruar në Mitrovicë. Inxhinierë e diplomuar e elektroteknikës drejtimi "Kompjuterikë me Telekomunikacion" ,Master i shkencave kompjuterike, Magjistër i Informatikës. Në sindikatë fillimisht jam zgjedhur Kryetare e Sindikatës së Gjimnazit “Frang Bardhi” në Mitrovicë,më pastaj Nënkryetare e sindikatës komunale të Arsimit fillore dhe të mesëm të Mitrovicës, Kryetare e Sindikatës Komunale të Arsimit fillore dhe të mesëm në Mitrovicë, Kryetare e Sindikatës së Arsimit të Mesëm të Lartë të Kosovës dhe tani Nënkryetare e SBASHK-ut.

Arsimimi sot :

Cili do të jetë aktiviteti juaj si Nënkryetare e SBASHK-ut?

Vjollca:

Si Nënkryetare e SBASHK-ut në plotëni do ti përmbahem Statutit dhe akteve tjera të SBASHK-ut ku

në mënyrë të detajuar janë konkretizuar detyrat dhe obligimet. Në bazë të akteve normative kemi bërë plan programin e punës të detajuar në baza mujore, tre mujore, gjashtë mujore, nëntë mujore dhe vjetore. Janë bërë shumë angazhime dhe janë shënuar shumë arritje në SBASHK, por ka edhe punë për t’u bërë në mënyrë që të realizojmë obligimet dhe detyrat tona në vazhdimësi e gjithnjë në zgjidhjen e problemeve arsimore, mbrojtjen e punonjësve të arsimit për të drejtat në punë dhe të drejtat nga marrëdhënia e punës. Përmes bashkëpunimit të vazhdueshëm me Kryetarin dhe Kryesinë e SBASHK-ut, Kryetarët e niveleve komunale, Kryetarin e SUSHK-ut dhe me Këshillin Drejtues të SBASHK-ut dhe anëtarësinë do ti përcjellim të gjitha ngjarjet në arsimin e Kosovës dhe bashkërisht do të gjejmë zgjidhjet më të mira të mundshme.

Arsimi sot:

Cili është roli i femrës në angazhimin sindikal?

Vjollca:

Viteve të fundit angazhimi sindikal i femrës është përmirësuar dukshëm. Arsimin e Kosovës e mbulojnë mbi 51 % femrat dhe ato janë shumë të suksesshme në procesin edukativo-arsimor andaj edhe në angazhimet sindikale do të jenë të suksesshme. Në Kongresin e 7 të SBASHK-ut 40% të delegatëve ishin femra. Edhe në Këshillin Drejtues të SBASHK-ut anëtare janë 40% femra. Na mbetet të punojmë në nivelet komunale pasi aty kemi vetëm një Kryetare të nivelit komunal.

Arsimi sot:

Jeni shumë aktive në sindikatë. Si e arrini këtë?

Vjollca:

Me vullnet dhe dëshirë çdo gjë arrihet. SBASHK-u organizatë e vetme që punon për të mbrojtur dhe avancuar të drejtat për punë dhe të drejtat në

Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës

marrëdhënien e punës për punonjësit e arsimit, e kjo është arsyeja që unë jam në sindikatë.

Arsimi sot:

Çfarë mendoni SBASHK-u duhet të bëjë më shumë në shërbim të anëtarësisë?

Vjollca:

Shërbime në përputhje me nevojat e anëtarësisë si zhvillim profesional, shkëmbim të përvojave brenda SBASHK-ut, nxitje dhe mbështetje të kryetarëve të niveleve komunale dhe kryetarit të SUSHK-ut për organizim të trajnimeve me anëtarësinë dhe bashkëpunimin dhe shkëmbimin e përvojave me sindikatat ndërkombëtare.

Arsimi sot:

Çfarë mendoni për projektligjin e viteve të 90-ta?

Vjollca:

Historia e Projektligjit të viteve të 90-ta është stërzgjatur. Ky projektligj kaqerë është dashur të aprovohet. Projektligji i viteve të 90-ta për arsimin shqip në Kosovë do ta gëzojnë të gjithë mësimdhënësit që kanë punuar në atë kohë dhe është kategorizuar në dy grupe ata që kanë punuar deri në 5 vite do ta gëzojnë pensionin meritator me 65 % të pagës bazë të arsimit fillor dhe ata të cilët kanë punuar mbi 5 vite deri në 10 vite 75% të pagës bazë të arsimit fillor. Pas shumë përpjekjeve të Kryetarit dhe Kryesisë së SBASHK-ut dhe gjithë anëtarësisë projektligji i viteve të 90-ta u aprovua në qeveri dhe u procedua në Kuvendin e Kosovës. Në Kuvendin e Kosovës në leximin e parë projektligji kaloi dhe besojmë që së shpejti edhe në leximin e dytë do të kaloi dhe të gjithë

mësimdhënësit e asaj kohe do ta gëzojnë pensionin meritator.

Arsimi sot:

A keni diçka të veçantë për të shtuar?

Vjollca:

Porosia ime për anëtarët e SBASHK-ut është të punojmë me ndërgjegje të plotë, ta ruajmë unitetin, të angazhohemi në zbatimin e Statutit të SBASHK-ut dhe të Ligjit mbi organizimin Sindikal. Po ashtu kam një porosi që njohuritë dhe përvojat e marra nga Seminaret, Konferencat e ndryshme që organizohen nga SBASHK në bashkëpunim me organizatat e ndryshme t'i përcjellim te Anëtarësia e gjerë nëpër Shoqatat Sindikale ku punojmë dhe veprojmë. Posaçërisht, do të angazhohemi në ngritjen e statusit të mësimdhënësve.

Në partneritet me MASHT-in, odën ekonomike dhe bizneset e Kosovës do të punojmë në hapjen e shkollave profesionale me drejtime dhe plan programe të posaçme bazuar në nevojat e tregut të punës, bashkëpunim të veçant do të zhvillojmë edhe me sindikatat ndërkombëtare. Në bashkëpunim me MASHT-in dhe Arsimin e Shqipërisë do të punojmë në hartimin, harmonizimin dhe unifikimin e teksteve mësimore. Të kontribuojmë në trajnime dhe aftësim të vazhdueshëm profesional të mësimdhënësve. Do të jemi gjithnjë aktiv në ndryshimet, plotësimet dhe realizime të Marrëveshjeve Kolektive, e në të njëjtën kohë do të monitorojmë implementimin e Kontratës Kolektive. Posaçërisht do të angazhohemi në unifikimin e qëndrimeve sindikale për problemet eventuale.

Faleminderit!



Gjatë muajit

Vazhdon rrugëtimi I mbarë i Ligjit për vitet e 90-ta

Deputetet në mbështetje të këtij ligji në leximin e parë

SBASHK-u i kishte dhënë prioritet angazhimeve në shërbim të realizimit të kërkesës madhore për të dërguar Projektligjin për statusin e punëtorëve të arsimit shqip të Republikës së Kosovës për vitet e 90-ta. Janë bërë shumë angazhime dhe përmes dialogut social dhe përmes veprimeve sindikale nga ana e SBASHK-ut duke dëshmuar kështu përkushtimin për të kryer misionin që kishim marrë në shenjë respekti për të punësuarit e asaj kohe të vështirë.



Më në fund , më 11 prill Projektligji filloi me rrugëtimin e mbarë. Qeveria e Republikës së Kosovës në krye me Kryeministrin Haradinaj e vuri në rend të ditës në mbledhjen e Qeverisë dhe e votoi Projektligjin duke i hapur mundësi që rrugëtimi i tij i mbarë të nis. Projektligji u gjend shuam shpejt në Komisionin Parlamentar për arsim dhe mori përkrahjen. SBASHK-u publikisht ka shprehur respekt për

Kryetarin, nënkryetaren dhe gjithë anëtarët e këtij Komisioni që ishin angazhuar vazhdimisht për Projektligjin.

Rrugëtimi i mbarë i Projektligjit vazhdoi dhe deputetet shqiptar të Parlamentit të Republikës së Kosovës diskutuan për të në leximin e parë. Pjesa më e madhe e tyre shprehen respektin për punën dhe angazhimin e përkushtuar të punëtorëve të arsimit shqip në vitet e 90-ta. Ata këtë ligj e çmuan të rëndësisë së veçantë dhe e votuan.

Rrugëtimi i Ligjit vazhdon dhe tani është në debat publik për të shkuar më pastaj në leximin e dytë dhe për t'u votuar përfundimisht. SBASHK-u është shumë i sigurt se deputetet shqiptar edhe pas leximit të dytë do ta votojnë këtë Ligj. Do ta votojnë sepse ata kanë respekt të lartë për pishtarët e dijes që me plot sakrificat mbrojtën shkollën dhe gjuhën tonë.



Vazhdon forcimi i kapaciteteve për udhëheqje efektive të dialogut social

Pjesëmarrësit e vlerësojnë lartë këtë aktivitet sindikal të SBASHK-ut



SBASHK-u është duke vazhduar me organizimin e trajnimeve me të zgjedhurit e ri në nivel shoqatash lidhur me

dialogun social. Kjo bëhet me qëllim të fuqizimit të kapaciteteve njerëzore për të marrë pjesë në mënyrë aktive në proceset e ndërlikuara të dialogut social në nivel lokal, kombëtarë e në nivel të Evropës.



Ky aktivitet është parë si shumë i rëndësishëm ngase po i ndihmon të zgjedhurit e ri që më lehtë të gjejnë zgjidhje për kërkesat e shtruar nga anëtarët nëpër shoqatat e tyre sindikale. Në kuadër të këtij aktiviteti është zhvilluar një trajnim i tillë me kryetarë shoqatash nga shkollat e ndryshme të Gjilanit, Prizrenit, Podujevës, Vitisë, Kamenicës, Lipjanit dhe Kaçanikut.



Kryetari i SBASHK-ut, Rrahman Jasharaj ka marrë pjesë edhe në këtë aktivitet të radhës duke përshëndetur pjesëmarrësit e pastaj ka kujtuar se njëra nga detyrat kyçe të SBASHK-ut është përgatitja e veprimtarëve sindikal për të marrë pjesë aktive në dialogun sindikal, pasi që dialogu është njëri nga mjetet fort të rëndësishme i përpjekjeve për realizimin e kërkesave të anëtarësisë me partnerët tjerë social. Kryetari Jasharaj ka shtuar se janë organizuar një numër i madh i trajnimeve me temën kyçe që lidhet

me dialogun social dhe se pjesëmarrësit njohuritë e fituara i kanë përcjellë edhe te kolegët e tyre e po ashtu ky aktivitet ka bërë që veprimtarët sindikalë nga komuna të ndryshme të bashkëbisedojnë dhe të përcjellin përvoja nga komunat e tyre.



Trajneri i licencuar për dialogun social, Ymer Ymeri edhe në këtë trajnim ka shpalosur temat kyçe të trajnimit duke filluar nga përkufizimi për dialogun social, sfidat dhe kujdesi që duhet pasur gjatë dialogut, dialogu social kombëtar, ai në nivel të Evropës, roli i Këshillit Ekonomik Social në Kosovë dhe fushëveprimtaria e tij, dialogu social në Evropë dhe tema të tjera që ndërlidhen me dialogun social. Ai është ndihmuar nga kryetari Jasharaj dhe juristi në SBASHK, Blendor Shatri edhe gjatë shtjellimit të temave dhe punës në grupe por edhe gjatë bashkëbisedës duke u përgjigjur në pyetjet e ngritura sepse temat e trajnimit kanë nxitur këta veprimtar sindikalë të përmendin çështje nga aktualiteti dhe të kërkojnë edhe mendimin e trajnerëve se si do të duhej zgjidhur ato në mënyrën më të drejtë të mundshme.

Pjesë shumë interesante e dinamike ishte ajo e punës praktike për dialogun social kur pjesëmarrësit duke marrë rolin e sindikalistëve apo të tjetër atë të punëdhënësve kanë inskenuar dialogun social në përpjekje për të gjetur zgjidhje sa më të mirë për problemet e shtruar.

Pjesëmarrje në takime të nivelit të lartë sindikal

Në Bruksel takim i rëndësishëm për sindikatat dhe arsimin

Është organizuar në Bruksel Konferencë e nivelit të lartë me temën kyçe për rëndësinë e personelit mbështetës në arsim nga Internacionalja Botërore e Arsimit. Në këtë takim të rëndësishëm ishte pjesëmarrës edhe SBASHK-u, i përfaqësuar përmes sekretares së përgjithshme, Jehona Oruqi dhe menaxheri për financa, administratë e këshilltar për organizim sindikal, Ymer Ymeri. Delegacioni i SBASHK-ut u nënshkrua publikisht edhe në deklaratën e përbashkët që doli nga kjo Konferencë e nivelit të lartë lidhur me angazhimet për realizimin e çështjeve të ngritura këtu.



Se kjo Konferencë ishte e rëndësisë së veçantë flet edhe fakti se në të mori pjesë edhe sekretari i përgjithshëm i EI-së, David Edvards dhe personalitete të tjera të larta sindikale e arsimore nga e tërë bota. Konferenca vuri në pah rëndësinë e madhe të

personelit mbështetës në shkolla me qëllim të arritjeve më të mëdha në sistemin arsimor. Pjesëmarrësit prezantuan përvojat e tyre nga kjo sferë dhe me vëmendje të veçantë është përcjellë prezantimi i Federatës së Mësuesve të Amerikës (AFT).



Çështje më rëndësi që janë ngritur në këtë Konferencë janë edhe ajo për kushtet e punës , ngritja e vazhdueshme profesionale e mësimeve, mbështetja që duhet dhënë arsimit nga institucionet shtetërore e çështje të tjera.

Pjesëmarrësit në bashkëbiseda e përmes grupeve të punës janë pajtuar se sfidat dhe problemet aktuale janë të njëjta kudo në shtetet e botës dhe se duhet angazhim I përbashkët për zgjidhjen e tyre në shërbim të arsimit dhe të punësuarve në këtë sektor tepër të rëndësishëm. Konkluzion i përbashkët është se personeli mbështetës nuk duhet ndarë nga sistemi arsimor, por duhet të jetë pjesë me rëndësi e tij. Pjesëmarrësit janë shprehur kategorik se nuk duhet lejuar privatizimin e personelit mbështetës, porse duke filluar nga çerdhet e deri të nivelet tjera arsimore ato duhet të jenë pjesë e edukimit dhe arsimit. Pasi që 16 maji është dita botërore e personelit mbështetës (ESP) kjo Konferencë publikoi Deklaratën për të drejtat dhe statutin e ESP-së.

Përfaqësuesit e SBASHK-ut, krahas kontributit në punimet e Konferencës dhe punës në grupe kanë

zhvilluar edhe takime të rëndësishme me përfaqësues sindikal e arsimor. Ata kishin një takim të frytshëm e përmbajtjesor me sekretarin e përgjithshëm të Internacionales Botërore të Arsimit, David Edvards. Sekretari I përgjithshëm I EI-së, Edvards u njoftua me angazhimet, sfidat dhe arritjet e sindikatës sonë duke shprehur kënaqësinë për këto angazhime dhe gatishmërinë për bashkëpunim e përkrahje të vazhdueshme ndaj SBASHK-ut në angazhimet për realizimin në plotëni të misionit të saj sindikal e në

shërbim të anëtarësisë. Përfaqësuesit e SBASHK-ut janë takuar edhe me nënkryetaren e Federatës së Mësuesve të Amerikës (AFT), znj. Lauren Sanet . Takime të frytshme ishin edhe ato me kryesuesen e delegacionit të Asosacionit të Mësuesve Amerikanë,znj. Amber Parkesrs dhe me kolegët nga Sindikata e Arsimit të Sllovenisë (SVIZ), me të cilët u bisedua për angazhimet aktuale sindikale dhe për bashkëpunimin mes tyre dhe sindikatës sonë edhe në ardhmen.

Në Sofje Sindikatat nga e tërë Evropa diskutojnë për Ballkanin Perëndimor

Kontribut për takimin e 17 majit të krerëve të shteteve

Në Sofje të Bullgarisë, që është kryesuese e Këshillit të Evropës, është organizuar Konferencë e nivelit të lartë në kohezionin ekonomik e shoqëror për Ballkanin Perëndimor.



Në hapje të këtij takimi, znj. Ekatarina Saharieva, Zëvendës kryeministre dhe ministre e punëve të jashtme e Bullgarisë, ka folur për rëndësinë e këtij takimi duke veçuar se Bullgaria është duke punuar vazhdimisht në përkrahje të ecjes përpara të vendeve të Ballkanit Perëndimor duke mbështetur ato që të kryejnë reformat dhe të bëhen sa më shpejtë , që është e mundur, pjesë e BE-së. Ajo ka kujtuar se janë bërë angazhime të mëdha, porse ka mbetur edhe mjaft punë për t'u bërë.



Për situatën aktuale dhe për angazhimet që duhen bërë shtetet e Ballkanit kanë folur edhe panelistët Colin Volfe, përfaqësues i Komisionit Evropian lidhur me programet për Ballkanin Perëndimor, Sergja Kekoviç panelit nga Mali i Zi, Peter Sanfej nga Banka Evropiane për Zhvillim, por edhe panelistë nga vetë shtetet e Ballkanit Perëndimor. Të gjithë ata kanë shprehur bindjen se duhet bërë ende shumë angazhime për kryerjen me sukses të detyrave , secili në shtëpinë e tij, në mënyrë që të krijohet mundësi e re për t'u bërë pjesë e BE-së. Shumë nga pjesëmarrësit janë shprehur se BE-ja duhet të ketë një qasje më ndryshe nga kjo e tashmja lidhur me vendet e Ballkanit Perëndimor në mënyrë që t'u ndihmohet më shumë dhe t'u hapet hapësirë që sa më shpejtë të jnë pjesë e BE-së. Në këtë Konferencë të nivelit të lartë Kosovën e kanë përfaqësuar kryetari i BSPK-së, Avni Ajdini dhe kryetari i SBASHK-ut, Rahman jasharaj. Kryetari Ajdini ka paraqitur pikëpamjet e BSPK-së për çështjet

e ngritura dhe ka theksuar se po bëhen angazhime të shtuara në realizimin e kërkesave të anëtarësisë. Edhe ai ka kërkuar që BE-ja të ketë qasje më aktive ndaj Ballkanit Perëndimor duke mbështetur edhe Kosovën në angazhimet e saj të vazhdueshme që të jetë sa më parë pjesë e familjes së madhe të shteteve në BE.

Siç u tha në hapje të këtij takimi të nivelit të lartë, kjo Konferencë është planifikuar si kontribut për Samitin e Krerëve e të Shteteve të Ballkanit perëndimor, programuar nga institucionet më të larta bullgare , që mbahet nga data 17 maj.